



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 663 Akti

Nr. 538 Vendimi
Tiranë, më 7.6.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 7.6.2022, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Elona Alvora**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5, e nenit 179/ b, të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”:

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Elona Alvora, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Trupi gjykues, i shortuar për të shqyrtuar çështjen, përbëhej nga komisionerët: Alma Faskaj, me cilësinë e relatores, si dhe Pamela Qirko dhe Xhensila Pine, anëtare të tij. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 21.12.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionere Pamela Qirko.

3. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Francesco Ciardi. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët.

4. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, si dhe veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

6. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar duke konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*

¹Raporti i ILDKPKI-së dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 30.1.2018.

- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

7. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar² duke konkluduar mbi *përshatshmëri për vazhdimin detyrës së subjektit të rivlerësimit Elona Alvora.*

8. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm³ dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

9. Në vijim, nga relatorja e çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

10. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes Alma Faskaj, me vendimin e datës 19.4.2022 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Elona Alvora, njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 -47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i kaluar subjektit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

11. Për një proces të rregullt ligjor subjektit të rivlerësimit Elona Alvora i janë garantuar të drejtat, si: njoftimi për fillimin e procedurës së rivlerësimit, njoftimi mbi përbërjen e trupit gjykues dhe për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/ shpjegimet mbi rezultatet e hetimit.

12. Subjekti i rivlerësimit Elona Alvora, pasi u njoh me rezultatet e hetimit administrativ, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e saj në datën 28.4.2022 dhe lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni.

13. Komisioni, me vendimin e datës 10.5.2022, për shkak të largimit për një afat të pacaktuar të komisioneres Alma Faskaj, për arsye objektive (shëndetësore), ka vendosur me short zëvendësimin e saj me komisioneren Suela Zhegu, në cilësinë e relatores së çështjes, e cila në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit. Subjekti, pasi u njoh me vendimin e Komisionit datë 10.5.2022 për zëvendësimin e relatores së çështjes, deklaroi se nuk ka konflikt interesi.

²Raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017, i deklasifikuar plotësisht më vendimin nr. ***, datë 27.10.2021, të KDZh-së.

³Raporti nr. ***, datë 18.5.2021, i KLP-së.

14. Me vendimin datë 10.5.2022, trupi gjykues vendosi riçeljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Elona Alvora për të tria kriteret e rivlerësimit, bazuar në propozimin e relatores Suela Zhegu, e cila kërkoi kohën e nevojshme për t'u njohur me të gjitha materialet e dosjes së hetimit, si dhe me rezultatet e hetimit administrativ të përgatitura nga relatorja Alma Faskaj, me të cilat subjekti i rivlerësimit ishte njohur dhe kishte dërguar prapësimet e saj pranë Komisionit.

15. Me vendimin e datës 26.5.2022, trupi gjykues, pasi dëgjoji relatoren e çështjes, e cila shprehu se nuk kishte hapa hetimorë të tjerë për të ndërmarrë, vendosi të mbyllë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Elona Alvora bazuar në tri kriteret e vlerësimit, si dhe njoftoi subjektin për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ.

16. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe të provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e kryer elektronikisht në datën 26.5.2022.

18. Seanca dëgjimore për subjektin Elona Alvora u zhvillua në datën 31.5.2022, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

19. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIM DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Subjekti i rivlerësimit Elona Alvora ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve". Gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ znj. Elona Alvora ka qenë bashkëpunuese, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

22. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e

ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

23. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

24. Ndërsa, sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

25. Referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

26. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI-ja dhe deklaratat periodike të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d. provat shkrese/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- e. raportin e kontrollit të figurës së dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f. raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- g. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h. shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

27. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Elona Alvora, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, u krye mbi bazën e tri kritereve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

Komisioni, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me: gjendjen pasurore; burimet e krijimit; të ardhurat; shpenzimet; mundësitë për fshehje të pasurisë; deklaram të rremë apo konfliktin e interesit.

28. Në deklaratën e pasurisë *Vetting* të datës 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë si vijon:

1. Tokë arë⁴, në masën 20% të sipërfaqes 3300 m², *, Tiranë**

Kjo pasuri është përfutur si familje bujqësore me AMTP-në nr. ***, datë 17.5.1996, në zbatim të ligjit nr. 7501/1991, “Për Tokën”, në Njësinë Administrative ***. Në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës në vitin 2009, subjekti ka deklaruar sipërfaqe tokë bujqësore të fituar me ligjin nr. 7501, e paregjistruar për shkak se paraqitet me problem. Sipërfaqja 660 m² me përafërsi.

1.1 Hetimi i Komisionit

ASHK Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2⁵ ka informuar se në emër të shtetasit A.A.A (babai i subjektit) figurojnë të regjistruara në zonën kadastrale *** pasuritë:

- arë me sip. 1.800 m², vol. ***, f. ***;
- arë me sip. 1.500 m², volum ***, f. ***.

Në lidhje me mënyrën e fitimit saktësohet se këto pasuri janë fituar në zbatim të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën” sipas AMTP-së nr. ***, datë 17.5.1996.

Referuar AMTP-së nr. ***, datë 17.5.1996, shtetasi A.A ka përfutur tokë bujqësore në sipërfaqe totale 3300 m², e cila është e ndarë përkatësisht në tokë arë me sip. 1800 m² dhe tokë vresht me sip. 1500 m², por kjo sipërfaqe edhe pse është vresht është regjistruar tokë arë.

Bashkëlidhur me kthim përgjigjen gjendet dokumentacioni i fitimit dhe regjistrin të pasurive në ZVRPP-Tiranë, nga i cili konstatohet edhe problematika e referuar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave pasurore përpara fillimit të detyrës⁶.

⁴Vërtetim i datës 7.2.2016, nga ZVRPP-ja Zyra Vendore Tiranë se nga verifikimi në z. k. ***, ***, gjatë verifikimit u gjet AMTP “fotokopje” në listën Tapi, fshati ***, në emër të z. A.A; AMTP-ja nr. ***, datë 17.5.1996, në emër të z. A.A, në fshatin ***, nga ku rezulton se ka përfutur sipërfaqe toke bujqësore arë me sip. 1500 m² dhe vresht 1500 m²; kartelë për pasurinë nr.***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në emër të z. A.A, me sip. 1500 m² arë; kartelë për pasurinë nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në emër të z. A.A, me sip. 1800 m², e llojit “arë”, e cila ka shënimin “mbyllur” dhe se vijon në vol. ***, f. *** dhe vo. ***, f. ***.

⁵Shkresë nr. *** prot. datë 4.2.2021.

⁶Sipas përmbytjes së kartelës së pasurisë me nr. ***, me sip. 1800 m² rezulton se kjo pasuri ka shënimin “mbyllur” dhe është ndarë në dy pasuri të tjera, të cilat vijnë përkatësisht në vol. ***, f. *** dhe vol. ***, f. ***. Nga këqyrja e mëtejshme e dokumentacionit tekniko-ligjor të përcjellë nga DVASHK-ja konstatohet se pasuria në volum ***, faqe ***, z. k. *** është regjistruar pas ndarjes në pasurinë me nr. ***, në emër të shtetasit E.S me sip. 1400 m². Në praktikën e dërguar nga DVASHK-ë Tirana Rurale 2 ,sipas shkresës me nr. ***, datë 1.7.2020, urdhër i brendshëm, konstatohet se pasuria me nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “arë”, me sip. 2000 m² e afishuar në emër të shtetasit A.A.A disponon parcelën ***, me sip. 1800 m², e cila është më e vogël sesa sipërfaqja e kësaj pasurie, sipas hartës së zyrës. Pjesa tjetër e kësaj sipërfaqeje i përket shtetasit E.S. Në përfundim të këtij urdhri është urdhëruar korigjimi i sipërfaqes së pasurisë me nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “arë” nga 2000 m² në 3200 m² dhe ndarja e saj në: pasurinë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 1800 m², në emër të z. A.A; pasurinë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 1400 m², në emër të shtetasit E.S. Për pasurinë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 1500 m², nga konsultimi Komisionit me sistemin dixhital të pasurive të paluajtshme, referuar dokumentacionit të gjeneruar nga ky sistem sipas kartelës së pasurisë së kësaj pasurie në Seksionin D - Kufizimet e Pronësisë konstatohet shënimi “bllokohet në bazë të urdhrin nr. ***, datë 15.3.2006”. Referuar AMTP-së nr. ***, datë 17.5.1996, rezulton se z. A.A ka përfutur tokë bujqësore në sipërfaqe totale 3300 m², e cila është e ndarë përkatësisht në tokë arë me sipërfaqe 1800 m² dhe tokë vresht me sipërfaqe 1500 m², por kjo sipërfaqe edhe pse është vresht është regjistruar tokë arë. ASHK-ë,⁶ Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë informon Komisionin se në emër ose bashkëpronësi për ndërtime të deklaruara në proces legalizimi ose të regjistruara nga shtetasja E. A.A dhe personat e lidhur me të, rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit A.A.A është aplikues në procesin e legalizimit me formular A, nr. *** prot., ***, Tiranë. Sipas formularit të vetëdeklarimit bashkëlidhur kthim përgjigjes rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit A.A.A, në datën 15.11.2006, ka aplikuar për të legalizuar shtesë pallati anësore me sipërfaqe ndërtimi 33.25 m². Nga hetimi administrativ në lidhje me këtë pasuri, rezultoi se shtëpia e banimit

ILDKPKI-ja⁷, në kuadër të procesit të rivlerësimit për subjektin, përcjell në Komision procesverbalin e datës 2.2.2016, në të cilin rezulton se subjekti është pyetur se ku banon ajo dhe familja e saj dhe sa shpenzojnë.

Subjekti ka shpjeguar se: “*Familja ime e përbërë nga motrat dhe prindërit jetojnë në Njësinë Administrative ***, ish- *** në një banesë të përfituar që nga viti 1982*”.

Nga hetimi i Komisionit rezultoi se subjekti zotëron 1/5 pjesë taksuese të pasurisë së përfituar me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën” si anëtare e familjes bujqësore sipas certifikatës së përbërjes familjare më 1.8.1991.

1.2 Vlerësimi i Komisionit

Në analizë të shpjegimeve dhe deklarimeve të subjektit, në raport me tërësinë e provave të administruar, trupi gjykues çmoi se deklarimi i subjektit, në deklaratën *Vetting*, përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit dhe nuk u konstatuan problematika në këndvështrim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”. Subjekti ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasurinë në bashkëpronësi, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

2. Depozitë kursimi në shumën 204.555 lekë

Kjo depozitë është 100% në zotërim të subjektit, çelur në “Credins Bank”, në vitin 2010. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga si sekretare gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe bursa gjatë studimeve në Shkollën e Magjistraturës.

2.1 Hetimi i Komisionit

“**Credins Bank**”⁸ ka informuar se znj. Elona Alvora ka hapur llogari depozite në “Credins Bank” në datën 5.8.2005, përpara fillimit të detyrës, duke derdhur *cash* vlerën 100.000 lekë.

2.2 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, për harkun kohor 1.1.2011 - 7. 9.2011, rezultoi se subjekti kishte mundësi të mjaftueshme financiare për të krijuar kursime në shumën totale 384.921 lekë.

Nga analizimi i dokumentacionit bankar rezultoi se vlera e depozitës është rritur gjatë viteve nga akumulimi i interesave dhe nga derdhje të tjera të realizuara përgjatë viteve 2016 – 2018 nga subjekti dhe në total vlera e derdhjes *cash* është 610.000 lekë.

Nga hetimi i Komisionit rezulton se subjekti ka punuar si sekretare gjyqësore në periudhën dhjetor 2006 - shtator 2007 dhe ka përfituar të ardhura *neto* nga paga në vlerë totale prej 200.168 lekësh, ndërsa gjatë viteve 2007 – 2009 ka përfituar të ardhura *neto* në shumën 1.040.899 lekë, nga bursa në Shkollën e Magjistraturës.

ka filluar të legalizohet në vitin 2006, sipas ligjit nr. 9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. Sa më sipër, këto veprime janë përpara se të bëhet subjekt rivlerësimi, si dhe në kohën e aplikimit të babait të saj për legalizim subjekti nuk ka qenë në përbërje familjare me ta.

⁷Shkresë nr. ***, datë 5.3.2021.

⁸Shkresë nr. *** prot., datë 1.2.2021, nga “Credins Bank”.

2.3 Vlerësimi i Komisionit

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezultoi se subjekti kishte mundësi të mjaftueshme financiare për krijimin e kësaj depozite dhe deklarimi i saj përputhet me të dhënat e bankës.

3. Llogari rrjedhëse në “Credins Bank”, me vlerë të mbetur në shumën 6.000 lekë

“Credins Bank”⁹ ka konfirmuar se llogaria rrjedhëse është hapur në datën 5.1.2010 dhe në këtë llogari janë transferuar pagat e subjektit të rivlerësimit, fillimisht, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (dhjetor 2009) dhe në vijim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

3.1 Vlerësimi i Komisionit

Nga verifikimi i kryer nuk u paraqitën problematika, gjendja e llogarisë së deklaruar nga subjekti përputhet me të dhënat bankare të ardhura nga “Credins Bank”¹⁰.

4. Apartament në përdorim

Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: *“Apartament i marrë në përdorim mbi bazën e kontratës verbale nga poseduesi (jo nga pronari M.B, i cili ndodhet jashtë shtetit), i ndodhur në lagjen ‘***’, Vlorë, pallati përballë sigurimeve shoqërore, kati i gjashtë. Përdorimi kundrejt pagimit të detyrimit”*.

Në rubrikën detyrime financiare ndaj personave juridike e fizikë të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar se: *“Për këtë apartament nuk posedoj kontratë të shkruar, pasi pronari M.B ndodhet jashtë Republikës së Shqipërisë dhe pritet ardhja e tij për lidhjen e saj. Vlera: 15.000 lekë/muaj, detyrim nga janari 2017”*.

Nga verifikimi i deklarimeve periodike të viteve 2010 – 2016 ka rezultuar se subjekti ka deklaruar si vendqëndrim tjetër “Vlorë”, pa saktësuar adresën e plotë të banesës në përdorim. Subjekti, e pyetur nga Komisioni gjatë hetimit, ka deklaruar se marrëdhënien e ka pasur verbale me shtetasen V. SH., vjehrra e pronarit të apartamentit, pasi ky i fundit jetonte jashtë shtetit. Nisur nga fakti se marrëdhënia ishte verbale dhe shpenzimi vjetor ishte në vlerën 180.000 lekë, subjekti gjatë hetimit ka shpjeguar se nuk kishte detyrim për të deklaruar këto shpenzime në deklaratat periodike vjetore. Subjekti, gjatë hetimit, deklaroi se kontaktin e parë fizik me pronarin e këtij apartamenti, M. B., e ka marrë në kohën e plotësimit të deklaratës *Vetting*, ku i ka kërkuar edhe një numër llogarie për të kryer pagesat nëpërmjet bankës. Pagesat e përdorimit të apartamentit janë kryer në llogarinë bankare të shtetasit M.B, duke filluar nga viti 2018 e në vijim, sipas dokumenteve bankare.

4.1 Hetimi i Komisionit

Komisioni hetoi mbi origjinën e apartamentit në përdorim dhe, referuar arkivës dixhitale të pasurive të paluajtshme të ASHK-së, ka rezultuar se në emër të shtetasit M.N.B figuron pasuria me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit apartament në qytetin e Vlorës.

⁹Shkresë nr. *** prot., datë 1.2.2021, nga “Credins Bank”.

¹⁰Shkresë nr. *** prot., datë 1.2.2021, nga “Credins Bank” .

DVASHK-ja Vlorë¹¹ ka depozituar kontratën me nr. ***, datë 22.10.2004,¹² me të cilën shtetasi M.N.B ka blerë pasurinë apartament, nga shtetasi M dhe N.Ç, në vlerën 1.500.000 lekë¹³. Referuar dokumentacionit të përcjellë nga DVASHK-ja Vlorë konstatohet se shtetasi M.B nuk e ka regjistruar pasurinë në ZVRRP-në Vlorë.

Në kuadër të procesit të rivlerësimit, ILDKPKI-ja¹⁴ ka përcjell në Komision kopje të deklarimeve për kryerje pagese dhe shlyerje detyrimi nga znj. Elona Alvora dhe marrës i saj z. M.B për periudhën janar - dhjetor 2017. Gjithashtu, subjekti ka depozituar një deklaratë (shkresë e thjeshtë) të datës 4.1.2018, të lëshuar nga shtetasi M.B, i cili ka deklaruar se: *“Për shtëpinë e dhënë në përdorim, të ndodhur në lagjen ‘***’, rruga ‘***’ nd. ***, h. ***, ap. ***, Vlorë, shtetases Elona Alvora, pagesa mund të bëhet në llogarinë bankare në ‘Alpha Bank’”*.

ILDKPKI-ja ka përcjell procesverbalin e mbajtur në datën 2.2.2016, sipas të cilit subjekti është pyetur se ku banon, aktualisht, ajo dhe familja e saj dhe sa shpenzojnë. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Familja ime e përbërë nga motrat dhe prindërit banojnë në Njësinë Administrative ***, ish- ***, Tiranë, në një banesë të përfutuar nga prindërit nga viti 1982. Unë, meqenëse punoj si prokurore në Prokurorinë e Vlorës dhe atje nuk kam banesë me qira, qëndroj në hotel dhe udhëtoj çdo 2-3 ditë drejt Tiranës, për këtë arsye shpenzimet janë më të mëdha se përbëhen nga shpenzimet e udhëtimit, hotelit, etj., të cilat i përballoj me të ardhurat e mia nga paga”*.

OSHEE-ja¹⁵ ka informuar se me gjeneralitet¹⁶ M.B, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një abonent me kontratë të furnizimit me energji elektrike nr. ***, Vlorë. Rezulton se është i njëjti numër kontrate të furnizimit me energji elektrike në emër të shtetasis M.B në kopjet e librezës së energjisë elektrike të përcjella nga subjekti i rivlerësimit.

Ujësjellës Kanalizime Vlorë¹⁷ ka informuar se shtetasi me emrin M.B është klient me numër kontrate ***, numër klienti ***, i cili është unik për secilin klientë të regjistruar, kabina Union lagja “***”.

Gjatë hetimit, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar¹⁸ se: *“Kontratat për furnizimin me ujë dhe drita janë në emër të shtetasis M.B. Vlera e konsumuar e ujit dhe dritave është paguar prej meje nga dhjetori i vitit 2010, e në vijim”*.

¹¹Shkresë nr. *** prot., datë 1.4.2022, nga DVASHK Vlorë.

¹²Me kontratën nr. ***, datë 28.11.2003, shtetasi M.Ç blen nga shtetasi L.M përfaqësues me prokurë të posaçme, i shoqërisë “***” sh.p.k., një apartament 1+1, në katin ***, nga toka të banesës nr. *** në krahun verilindor të banesës me sipërfaqe totale 59.4 m², në vlerën 2.100.000 lekë. Pasuria është regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. ***, datë 10.5.2004, në bashkëpronësi të bashkëshortëve M dhe N.

¹³Rezulton se subjekti në vitin e blerjes së apartamentit nga z. M.B (2004) ka qenë 20 vjeç (i datëlindjes 11.1.1984), duke ndjekur studimet e larta. Ndërsa në lidhje me referencat me EKB-në të vlerës së blerjes së apartamentit nga z. M.B rezulton se për qytetin e Vlorës, kostoja për metër katror të sipërfaqes së shfrytëzueshme është 29.375 lekë/m² ose për sip. ndërtimi 25.113 lekë/m². Rezulton se çmimi për apartamentin e blerë nga z. M.B është 30.612 lekë/m² (sip. e shfrytëzueshme) ose 25.253 lekë/m² sip. ndërtimi. Pra, apartamenti nga z. M.B është blerë me vlera më të larta se referencat e EKB-së për atë vit në qytetin e Vlorës.

¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 5.3.2021.

¹⁵Shkresë nr. *** prot., datë 9.12.2021.

¹⁶Me gjeneralitetet M.N.B, referuar sistemit të faturimit, nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë të furnizimit me energji elektrike.

¹⁷Shkresë nr. *** prot., datë 24.11.2021, nga UKV-ja.

¹⁸Në përgjigjet e pyetësorit nr. 5.

Në analizë të dokumentacionit të administruar, Komisioni konstatoi se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit përputhen me dokumentacionin mbi kontratën e shërbimit nga operatorët UKV dhe FSHIU¹⁹, ku rezultoi i njëjti numër kontrate të furnizimit me energji elektrike në emër të shtetasit M.B në kopjet e librezës së energjisë elektrike të përcjella nga subjekti i rivlerësimit.

Komisioni, për një hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës hetoi lidhur me pronarin e ligjshëm të këtij apartamenti. Nga hetimi i kryer në sistemin *TIMS* rezultoi se shtetasi M. B. ka hyrje në territorin në shqiptar në dhjetor të vitit 2012 dhe nuk ka të dhëna për dalje prej tij në vitet në vijim. Nga të dhënat e AMF-së *online* rezultoi se shtetasi M. B. ishte pronar i automjetit tip “****”, me targa *** dhe ka prerë policat e sigurimit për automjetin në vitet 2017 dhe 2018.

Nisur nga këto dhëna të pakta, duket se shtetasi M. B. nuk duhet të ketë jetuar në Shqipëri në këto vite, ku subjekti deklaroi marrjen me qira të apartamentit.

Komisioni hetoi lidhur edhe me konfliktin e interesit, nëse gjatë ushtrimit të detyrës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë subjekti i rivlerësimit kishte hetuar kallëzime apo procedime me palë shtetasit M.B dhe V.SH. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë²⁰ informon se nga verifikimi i bërë nga sistemi kompjuterik nuk rezultoi të ketë të regjistruar kallëzim/procedim penal, hetuar nga subjekti i rivlerësimit për shtetasit M.B dhe V.SH.

Komisioni hetoi edhe lidhur me konfliktin e interesit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë edhe për shtetasit M.H.Ç dhe shoqërinë “****” sh.p.k., si dhe shtetasit S.M e S.C. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka informuar²¹ se nuk rezultoi të jetë/jenë regjistruar kallëzim/procedime penale të hetuar nga subjekti i rivlerësimit në ngarkim të shtetasve M.Ç, N.Ç, shoqëria “****” sh.p.k. dhe administratori i saj S.M.

4.2 Konstatime të Komisionit

Komisioni, gjatë hetimit, ka konstatuar mospërputhje të deklaratimeve mbi përdorimin e apartamentit të ndodhur në lagjen “****”, Vlorë, për vitet 2010 – 2017 dhe vitin 2017 e në vijim, si dhe shkakun e mosdeklarimit të përdorimit të apartamentit kundrejt pagesës për vitet 2010 – 2017.

Marrëdhënia e qirasë, e deklaruar për këtë apartament, nuk përputhet me deklaratimet e mëparshme të subjektit se ajo nuk ka jetuar me qira, por e ka bërë rrugën vajtje - ardhje për në Vlorë për një periudhë disavjeçare.

Mbi këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime.

4.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësime, si dhe gjatë shpjegimeve të dhëna në seancën dëgjimore, subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit, duke shpjeguar²² se: *“Strehimi është konsideruar shpenzim që*

¹⁹Me emrin M.B referuar të dhënave të sistemit të faturimit identifikohet një abonent me nr. ****, në instancën Vlorë, rezultoi se është i njëjti numër kontrate të furnizimit me energji elektrike në emër të shtetasit M.B në kopjet e librezës së energjisë elektrike të përcjella nga subjekti i rivlerësimit.

²⁰Shkresë nr. *** prot., datë 22.10.2021.

²¹Shkresë nr. *** prot., datë 18.3.2022, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

²²Përgjigje nr. 1 e pyetësorit nr. 3.

buronte nga marrëdhënia verbale që kisha me një person që nuk ishte pronar (i apartamentit të mobiluar) dhe që mund të përfundonte në çdo kohë. Likuidimi i shumave për përdorim është bërë dhe vijon të bëhet brenda çdo viti kalendarik. Ligji i kohës, kur janë bërë deklaratimet e pasurisë, përcaktonte detyrimin për të deklaruar vetëm shpenzimet mbi një vlerë të caktuar... Në deklaratat e mëpasshme të pasurisë (pra ato të dorëzuara pas deklaratave Vetting), deklarimi i përdorimit të apartamentit është bërë për shkak se janë marrëdhënie që kanë vijuar, pasi unë kam marrë kontakt të drejtpërdrejtë me pronarin e apartamentit të mobiluar... Në këto deklarata ndodhet edhe numri i llogarisë ku kanë vijuar të kryhen pagesat prej meje. Sa më sipër, e provoj me faktin se unë vijoj të jetoj tek i njëjti apartament që nga nëntori i vitit 2010, ku fillimisht pagesat i kam bërë në cash dhe më pas në numrin e llogarisë bankare që më është dhënë ...”.

Në lidhje me mospërputhjen e deklarimeve në ILDKPKI me atë të deklaratës Vetting, subjekti ka shpjeguar se: *“Mbi qëndrimin në qytetin e Vlorës dhe të marrëdhënies me shtetasin M.B deklarohet se ka qenë fakti se marrëdhënia kontraktore ka qenë me veprime konkludente të pamaterializuara ende edhe sot në një dokument dhe të mbështetur në besimin, ka bërë që kur më është dashur t’i vendos një emër ta konsideroj si përdorim (si në deklaratimet e mia, ashtu edhe në mandatet bankare). Mbase është e gabuar referenca ime në pjesën e hotelit, por në thelb ka qenë e njëjta gjë, pra unë, në kushtet ku thjesht e përdorja dhe nuk bëja investime, pra unë thjesht e kam përdorur si të shkosh me pushime diku dhe do të duash ta përdorësh diçka të caktuar. Qiraja tek ne si rregull është një veprim që ne e bëjmë me pronarin, unë zotërinë nuk e kam verifikuar në asnjë moment është pronar nuk është pronar, pra dikush është paraqitur ka thënë që po unë kam një apartament që është vjehrra e zotërisë, e kam parë apartamentin dhe ka vijuar marrëdhënia në këtë mënyrë, ishte s’ ishte pronar... duke qenë në një marrëdhënie verbale gjatë gjithë kohës ...për këtë arsye dhe unë nuk kam kërkuar dokumentacion apo çfarëdolloj gjëje. Unë i kam thënë që në Vlorë jam përkohësisht dhe në momentin që jam përkohësisht është një moment që sa më parë të largohem nga Vlora do dorëzoj apartamentin”.*

Në lidhje me shtetasin M.B, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se: *“Në rastin konkret, unë kam shkuar në Vlorë në vitin 2010, pra në moshën 26 vjeç, dhe për këtë person kam pyetur, qoftë policinë gjyqësore, nëse kanë informacion të caktuar, nëse ka të shkuar kriminale dhe informacioni që kam marrë ka qenë: jo nuk janë persona të tillë”.*

4.4 Vlerësimi i Komisionit

Në vlerësim të dokumentacionit të administruar, rrethanave dhe fakteve të dala gjatë hetimit, të deklarimeve të subjektit në deklaratën Vetting, të deklarimeve të saj gjatë hetimit dhe në prapësime, arsyeton se:

- Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe plotësisht në deklaratën Vetting apartamentin në përdorim në qytetin e Vlorës, përkundrejt një pagese mujore prej 15.000 lekësh/muaj.
- Nisur nga aktet ligjore lidhur me origjinën e pronës, ku referuar kontratës së shitblerjes rezulton se pronari i ligjshëm i apartamentit M. B. e ka blerë në vitin 2004, para se subjekti

të emërohej në detyrën e prokurores, referuar kontratës së shitblerjes²³. Në këtë vit subjekti ka qenë 20 vjeçe (e datëlindjes 1984), duke ndjekur studimet e larta.

- Nga verifikimi i kryer nuk rezultuan të dhëna mbi ndonjë situatë konflikti interesi me pronarin e apartamentit M. B apo me personin familjar të tij (vjehtë), tek e cila janë kryer pagesat e qirasë *cash* që nga nëntori i vitit 2010 dhe më pas provohen të jenë kryer nëpërmjet llogarisë bankare në favor të pronarit.
- Mospërputhjet e deklaramit në ILDKPKI lidhur me përdorimin e apartamentit në Vlorë, sipas shpjegime të subjektit, rrethanave dhe fakteve të dala gjatë hetimit, duket se kanë ardhur për shkak të marrëdhënies verbale të qirasë, e cila është mbajtur jo direkt me pronarin e ligjshëm, pasi z. B jetonte me familjen e tij jashtë Republikës së Shqipërisë, por me personin e lidhur, vjehtë e tij. Gjithashtu, mosdeklarimet në vite për apartamentin në përdorim lidhen me faktin se shpenzimi vjetor në vlerën 180.000 lekë nuk ka qenë një detyrim ligjor për deklaram, bazuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, sipas të cilit zyrtarët kanë detyrimin për deklaram për shpenzime mbi një vlerë të caktuar (pas vitit 2014 shpenzimi i deklarueshëm nga vlera mbi 500.000 lekë u ul në vlerën mbi 300.000 lekë).

Trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe rrethanave sa më sipër, në lidhje me banesën në përdorim, krijoi bindjen se nuk ka të dhëna për të ngritur dyshime të arsyeshme për këtë pasuri. Subjekti ka deklaruar saktë në deklaramen *Vetting* pasurinë në përdorim, në përputhje me nenin D/5 të Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, edhe sipas praktikës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit për këto marrëdhënie në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, subjektet e rivlerësimit kanë barrën e provës për të provuar se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me këta persona, në kuptim të parashikimeve të legjislacionit të posaçëm që rregullon këtë fushë (Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi i Procedurës Penale).

Analiza financiare përmbledhëse për periudhën 2009 – 2016

Përshkrimi	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	-79 769	255 303	146 705	-134 209	-254 036	-9 865	141 101	86 627
20% bashkëpronësi në pasurinë "Vreshtë" me sip. totale 3,300 m ² me nr. pasurie *** dhe *** të fituara nga familja bujqësore me kryefamiljar babain e subjektit, të ndodhura në K***, T****.								
Shtesa/pakesime likuiditete	-79 769	255 303	146 705	- 134 209	- 254 036	- 9 865	141 101	86 627
Total likuiditete	35 029	290 332	437 037	302 828	48 792	38 927	180 028	266 655
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0
PASURINETO	-79 769	255 303	146 705	-134 209	-254 036			
TË ARDHURA të dokumentuara	727 312	872 042	919 215	846 758	824 036	1 047 601	1 087 073	1 111 660
Të ardhura nga paga si Prokurore	63 014	870 664	917 360	842 964	814 276	1 039 758	1 083 699	1 109 085
Të ardhura nga botimi në revistën J*** dhe lehtësuese trajnimi në Shkollën e Magjistraturës	121 815							
Të ardhura nga bursa gjatë studimeve në shkollën e Magjistraturës	541 099							
Të ardhura nga depozita	1 384	1 378	1 855	3 794	9 760	7 843	3 374	2 575
SHPENZIME	205 370	201 620	350 620	454 548	391 024	399 998	404 276	415 092
Shpenzime për apartamentin në Vlorë të marrë nga poseduesi kundrejt		30 000	180 000	180 000	180 000	180 000	180 000	180 000
Shpenzime shkollimi në Fakultetin Ekonomik	68 750	35 000	34 000	135 000	70 000			
Shpenzime jetese	136 620	136 620	136 620	139 548	141 024	219 998	224 276	235 092
Analiza dokumentuar	601 711	415 119	421 890	526 419	687 048			

²³Rezultoni se subjekti, në vitin e blerjes së apartamentit nga z. M.B (2004), ka qenë në moshën 20 vjeç (datëlindja 11.1.1984), duke ndjekur studimet e larta. Ndërsa, në lidhje me referencat me EKB-në të vlerës së blerjes së apartamentit nga z. M.B, rezultoni se për qytetin e Vlorës kostoja për metër katror të sipërfaqes së shfrytëzueshme është 29.375 lekë/m² ose për sipërfaqe ndërtimi 25.113 lekë/m². Rezultoni se çmimi për apartamentin e blerë nga z. M.B është 30.612 lekë/m² (sipërfaqe e shfrytëzueshme) ose 25.253 lekë/m² sipërfaqe ndërtimi. Pra, apartamenti nga z. M.B është blerë me vlera më të larta sesa referencat e EKB-së për atë vit në qytetin e Vlorës.

Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë

Nga vlerësimi në tërësi i deklarimeve ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë pasuritë në deklaratën *Vetting* dhe nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje pasurie apo deklarim të rremë. Ndërkohë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura me burime të ligjshme për të mbuluar shpenzimet dhe krijuar likuiditete për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Subjekti nuk rezultoi të ketë qenë në kushtet e konfliktit të interesit. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Elona Alvora ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, DSIK-ja ka dërguar një raport²⁴ për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar *përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së znj. Elona Alvora*.

1. Hetimi i kryer nga Komisioni

Komisioni ka hetuar në lidhje me pastërtinë e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke kërkuar informacion për procedime të iniciuara ndaj subjektit të rivlerësimit Elona Alvora.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar²⁵ ka informuar se për subjektin e rivlerësimit rezultojnë të dhënat si vijon:

- Regjistruar procedimi penal nr. *** i vitit 2019, i cili ka ardhur për kompetencë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë. Ky procedim është në fazën e hetimit dhe nuk ka të regjistruar emra personash që i atribuohet vepra penale.
- Regjistruar procedimi penal nr. *** i vitit 2018, për veprën penale “korrupsion aktiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të lartë të drejtësisë”, i parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal. Ky procedim është në fazën e hetimeve paraprake. Prokuroria e Përgjithshme²⁶ ka informuar se rezultojnë 11 kallëzime²⁷ në ngarkim të subjektit të

²⁴Raport nr. *** prot., datë 2.11.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. *** , datë 27.10.2021, të KDZH-së.

²⁵Shkresë nr. *** prot., datë 15.2.2021.

²⁶Shkresë nr. *** prot., datë 31.3.2021.

²⁷Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2019, ka informuar se ka regjistruar kallëzimet penale: nr. *** , viti 2013, mbi bazën e kallëzimit të paraqitur nga shtetasi I.H, banues në Vlorë; nr. *** , viti 2015, mbi bazën e kallëzimit të paraqitur nga shtetasi A.XH; nr. *** , viti 2016, mbi bazën e kallëzimit të paraqitur nga shtetasi A.K, banues në Vlorë; nr. *** , viti 2016, mbi bazën e kallëzimit të paraqitur nga shtetasi I.SH, banues në Vlorë; nr. *** , viti 2016, mbi bazën e kallëzimit të paraqitur nga shtetasi F.M, banues në Vlorë; nr. *** , viti 2018, mbi bazën e kallëzimit të paraqitur nga shtetasi RR.D, banues në Vlorë; nr. *** , viti 2019, mbi bazën e kallëzimit të paraqitur nga shtetasi B.SH, banues në Vlorë, trajtuar në relacion, për të cilët, prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka konkluduar se veprimet e prokurores së çështjes janë kryer në respektim të normave procedurale penale dhe se nuk konstatohen elemente të ndonjë vepre penale.

rivlerësimi, për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit²⁸ penal, pasi faktet nuk parashikoheshin nga ligji si veprë penale.

Komisioni, pas verifikimit të akteve, ka konstatuar se për procedimet penale të regjistruara, ku është përmendur subjekti i rivlerësimit Elona Alvora, merr rëndësi fakti se subjekti nuk është as në cilësinë e personit nën hetim dhe as në cilësinë e të pandehurës për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

Komisioni ka vlerësuar se, referuar pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, subjekti nuk ka qenë as e dënuar dhe as e proceduar penalisht për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në krimin e organizuar²⁹. Subjekti ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin për kontrollin e figurës dhe në përputhje me dispozitat urdhëruese të ligjit. Nga analizimi i akteve nuk rezultuan fakte apo rrethana të cilat mund të përbëjnë provë që subjekti ka pasur kontakte të papërshtatshme.

2. Vlerësimi i Komisionit

Nga hetimi i Komisionit për vlerësimin e figurës, edhe pas përditësimit të të dhënave të ardhura nga autoritetet përkatëse, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

- Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Elona Alvora ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter u bazua në analizimin e:

- raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kriterëve të vlerësimit të parashikuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 71 e vijues i tij;
- denoncimeve të paraqitura nga publiku, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

Vlerësimi i aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit është kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i cili ka hartuar një raport³⁰ të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në:

²⁸Çështjet e informuara nga Prokuroria e Përgjithshme janë trajtuar nën kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

²⁹Referuar nenit 3, pika 15, e ligjit nr. 84/2016, është parashikuar se: “Person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, ‘Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë’, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë”.

³⁰Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vënë në dispozicion raportin profesional nr. ***, datë 18.5.2021, dhe aktet bashkëlidhur tij për subjektin e rivlerësimit. Ky raport është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. ***, datë 18.5.2021, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016,

- formularin e vetëdeklarimit;
- tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, në të dhënat e dokumenteve që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, si dhe në të dhënat nga burime arkivore;
- pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

Në lidhje me formularin e vetëdeklarimit, nga verifikimi i kryer, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi këtë formular.

Vlerësimi profesional referuar kritereve të vlerësimit, të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është si vijon:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

ANALIZA E GJETJEVE

1. Aftësitë profesionale

a. Njohuritë ligjore

Në lidhje me aftësitë profesionale ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Elona Alvora ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit dhe identifikon normën ligjore të zbatueshme. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Për sa i përket vlerësimit në aspektin profesional rezulton se ka shfaqur aftësi të mira në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të qarta. Subjekti i rivlerësimit Elona Alvora shfaq aftësi në pasqyrimin e rrethanave të faktit, analizën e provave dhe ballafaqimin e tyre me bazën ligjore të aplikueshme.

2. Aftësitë organizative

Subjekti i rivlerësimit Elona Alvora ka pasur ngarkesë të lartë sasiore për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, rreth 600 çështje të trajtuara. Duke pasur parasysh statistikën e ngarkesës së punës, konstatohet se prokurorja Elona Alvora është përballur me një ngarkesë të konsiderueshme pune, duke treguar eficiencë dhe efektivitet në marrjen e vendimeve brenda një afati të arsyeshëm, referuar natyrës dhe shumëllojshmërisë së veprimeve hetimore.

Nga vëzhgimi i pesë dokumenteve ligjore të përzgjedhura me short për periudhën e vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016 rezulton se afatet kohore të zgjidhjes së praktikave që kanë lidhje me

“Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rregulloren “Për vlerësimin etik e profesional të subjekteve në proces rivlerësimi”, ka miratuar këtë raport të hollësishëm dhe të arsyetuar të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike për përshkrimin dhe analizën e dokumenteve të vlerësimit profesional të subjektit Elona Alvora, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

dokumentet ligjore të përzgjedhura me short janë të arsyeshme në raport me natyrën dhe kompleksitetin e praktikave përkatëse.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të prokurores Elona Alvora. Gjithashtu, sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar nga Prokurori i Përgjithshëm ndonjë masë për procedim disiplinor.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Nga aktet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Elona Alvora. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu, nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t'u angazhuar, për periudhën objekt vlerësimi, subjekti Elona Alvora rezulton të jetë angazhuar në një sërë aktivitete profesionale të organizuara. Gjithashtu, në periudhën e rivlerësimit, subjekti deklaroi se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë Shkollës së Magjistraturës, duke shprehur gatishmërinë e saj për t'u rritur nga ana profesionale.

TË DHËNAT ARKIVORE (ankesat dhe masat disiplinore – vlerësimet)

1. Nga verifikimi në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë rezulton që ndaj subjektit të rivlerësimit, prokurore Elona Alvora, nuk janë marrë masa disiplinore. Nga Prokuroria e Përgjithshme janë administruar 4 ankesa të viteve 2012 – 2018, të cilat janë trajtuar nga ky institucion dhe nuk janë konstatuar problematika.

2. Inspektorati i Lartë i Drejtësisë³¹ ka përcjellë në Komisionin informacionin se për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 5 ankesa dhe dy prej tyre janë për verifikim pas shqyrtimit fillestar.

Lidhur me këto ankesa, Komisioni, pas analizimit të dokumentacionit ka konstatuar problematika si mangësi në hetime të konstatuara këto edhe nga gjykata, zvarritje të hetimit³², në kuptim të pikës 1, të nenit 6, të KEDNJ-së. Mbi këto konstatime, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime.

³¹Shkresë nr. *** prot., datë 19.1.2021, i ILD-së, ankesa me nr. *** prot., datë 10.7.2020, e gjyqtarit L.F.

³²Shkresë nr. *** prot., datë 4.2.2021, e ILD-së, e cila përcjellë ankesën e regjistruar me nr. *** prot., datë 11.3.2020, z. A.V lidhur me çështjen penale nr. ***, datë 16.12.2015; ankesa regjistruar me nr. ***, datë 8.1.2021, e z. M.C lidhur me procedimin penal nr. ***, i vitit 2017, për hetime për veprën penale “falsifikim dokumentesh”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; ankesa me nr. *** prot., datë 28.2.2020, e z. F.P, lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 27.7.2015, të vitit 2015 për veprën penale “pushtim të tokës”, parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal; ankesa regjistruar me nr. *** prot., datë 28.2.2020, e z. A.K lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 29.6.2017.

2.1 Qëndrimi i subjektit mbi ankesat në ILD³³

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegon se: “... ndryshe nga sa keni konstatuar ju, pikërisht kryerja apo moskryerja apo urdhërimi i kryerjes së veprimeve prej meje si prokurore e çështjes, do të konsiderohej si zvarritje për shkak të rezultateve që priten të prodhohen nga kryerja e tyre. Në lidhje me afatet kohore të lëna nga gjykata, në rastin e procedimeve penale pa autor, këto afate konsiderohen sugjeruese pasi gjykata është e interesuar për kryerjen e këtyre veprimeve që, si rregull, e pengojnë atë të marri vendim. Ju bëj me dije se afati varet jo vetëm nga sa ka përcaktuar gjykata, por gjithashtu nga çështjet prioritare për të hetuar, kohën që ke në dispozicion për të kryer punën si prokurore dhe nga policia gjyqësore, po ashtu edhe nga shkaqe të ndryshme që mund të dalin të dhëna të tjera që do të duhet të verifikohet ...”.

2.2 Subjekti, e pyetur në seancë dëgjimore mbi ankesën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, depozituar në ILD mbi pretendimin për sjellje joetike dhe profesionale në seancën gjyqësore me gjyqtar L. F në shqyrtimin e procedimit penal nr. ***, nëse kjo sjellje konsiderohet normale, pra largimi nga salla e gjyqit kur nuk i pëlqen një vendimmarrje, shpjegoi si vijon: “Unë nuk kam ikur në mënyrë demonstrative, nëse fjala thuhet dhe më pas bëhet veprimi sigurisht është tjetër gjë. Por, në momentin që bëhet një veprim i caktuar, pra unë e kisha ndërmarrë një kërkesë për gjykim dhe pavarësisht se si ishte e mirë, e gabuar, jo e gabuar nuk duhej të artikulohej në atë mënyrë. E kam parë vetën që kërkesat e mia nuk janë paraqitur sikurse ishin dhe në këto kushte kam kaluar në ato që thuhet vetëm me shkrim dhe po të shikosh seancën përkatëse, unë kam paraqitur me shkrim kërkesën time për moskompetencë lëndore në rastin konkret, për sa i përket të gjitha çështjeve unë kam dhënë shpjegimet e mia, sigurisht nuk pretendoj që të jem njeriu perfekt në atë që bëj, çdo gjë ka vend për përmirësimin tim, sikurse ka vend për përmirësimin e çdo personi tjetër në ushtrimin e detyrës së tij. Unë mendoj që në tërë veprimtarinë time në tërësi, besimi i publikut është rritur, besoj që i kam dhënë publikut të njëjtat standarde, pra për çështje të njëjta ligjore nuk konstatohet të jenë zgjidhur ndryshe për një subjekt dhe ndryshe për një subjekt tjetër, pra ka një standardizim të punës”.

2.3 Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues çmon se mangësitë e konstatuara janë të pashoqëruar me mangësi të tjera dhe në raport me ngarkesën e çështjeve të hetuara nuk janë të mjaftueshme për t'i çmuar si cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët apo një mënyrë pune e papajtueshme me funksionin e saj. Në këtë drejtim, trupit gjykues nuk i rezultuan *indicie* apo elemente në çështje të tjera për të ngritur dyshime se subjekti ka një mënyrë/model pune të papajtueshëm me pozicionin e saj dhe as shkelje të respektimit të të drejtave të palëve.

³³Ankesë nr. *** prot., datë 10.7.2020, e gjyqtarit L.F.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

Komisioni, në zbatim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ka analizuar 10 denoncime³⁴ të depozituara nga publiku, ndaj prokurores Elona Alvora.

Komisioni ka hetuar denoncimet duke analizuar edhe aktet përkatëse të përgatitura nga prokurori Elona Alvora, si dhe në raport me shpjegimet dhe provat e paraqitura prej saj, të cilat mund të merren në konsideratë në vlerësimin e aftësive profesionale, ka ndaluar vetëm në dy prej denoncimeve, atë të shtetasit G.A dhe të av. I.Z, të trajtuara në vijim, në dinamikën e tyre.

1. Denoncuesi G.S ka pretenduar në denoncimin e tij se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime, ka vendosur pushimin e çështjes pa arsye, si dhe ka sjellje dhe komunikim jo korrekt. Për këto shkaqe, ky shtetas ka kërkuar përjashtimin e subjektit të rivlerësimit. Denoncuesi i bashkëlidh denoncimit të tij dokumentacion³⁵ shoqërues.

Nga aktet e dosjes rezultoi se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është paraqitur kallëzimi penal nr. ***, datë 23.2.2015, nga shtetasi G.S për veprën penale “mashtrim”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, i cili ka kallëzuar shtetasit K.L dhe M.L, të cilët i kishin premtuar hapësira banimi në këmbim të sipërfaqes së truallit në të cilin kishte ndërtuar banesën ku jetonte.

Analiza e Komisionit

Pas verifikimit të akteve³⁶ ka rezultuar se denoncuesi G.S, në vitin 1998, ka ndërtuar një shtëpi banimi në truallin e pusit të naftës, në lagjen “****”, Vlorë, dhe ka jetuar qetësisht deri në vitin 2005. Ka rezultuar se ky shtetas ka bërë një marrëveshje me një shtetas tjetër, që në këmbim të truallit të shtëpisë, do të merrte sipërfaqe banimi në një ndërtim që do të bëhej mbi këtë truall. Për shkak se pala tjetër nuk realizoi për sa kishin rënë dakord dhe denoncuesi, ndërkohë, kishte pranuar t’i prishej shtëpia. Z. G.S, në vitin 2014, ka depozituar kallëzim në prokurori për veprën penale “mashtrim”.

Kjo çështje i ka rënë për trajtim subjektit të rivlerësimit dhe, në përfundim të hetimit të procedimit penal, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se nga tërësia e të dhënave mosmarrëveshjet ndërmjet palëve nuk përmbajnë elementë të ndonjë vepre penale, por këto janë fakte të një marrëdhënieje juridiko-civile dhe me vendimin e datës 24.3.2015 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal të kallëzimit nr. ***, të vitit 2015.

³⁴Denoncimet: nr. ***prot., datë 23.12.2019, nga shtetasi G.S; nr.*** prot., datë 14.11.2019, nga shtetasi A.T; nr. *** prot., datë 11.1.2019; nr. *** prot., datë 25.11.2019, nga shtetasja L.P; nr. *** prot., datë 20.9.2018, nga shtetasi A.K; nr. *** prot., datë 10.7.2020, nga shtetasi S.M; nr. *** prot., datë 22.11.2021, nga shtetasi I.Z. Denoncim nga shtetasi F.H. Denoncime të shoqërisë “****” sh.p.k. Denoncim nga shtetasi T.A. Denoncim i ardhur pas shpalljes së vendimit DH.G.

³⁵Kërkesë nr. *** prot., datë 18.7.2019, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për përjashtimin e prokurores Elona Alvora nga vazhdimi i mëtejshëm i hetimit të çështjes penale nr. ***, viti 2017. Kërkesë drejtuar Kryeprokurorit të Rrethit Vlorë; fotokopje të vendimit nr. ***, datë 12.3.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë; fotokopje të vendimit nr. ***, datë 5.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për plotësimin e hetimeve për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2017; ankimi i ankuesit G.S i datës 16.11.2015 ndaj vendimit të datës 11.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; kërkesë datë 5.5.2015, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. ***, datë 24.3.2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; vendim “Për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, datë 24.3.2015, të marrë nga subjekti i rivlerësimit; kallëzim penal nr. *** prot., datë 17.2.2015, depozituar në Prokurorinë e Rrethit Vlorë; vendim nr. ***, datë 11.11.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt “Kundërshtimi i vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. ***, datë 24.3.2015.

³⁶Shkresë nr. *** prot., datë 17.2.2021, e Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Vendimi i mosfillimit të procedimit penal të subjektit Elona Alvora është ankimuar nga shtetasi G.S dhe, në përfundim, me vendimin nr. ***, datë 27.6.2017, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur *ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 11.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke u shfuqizuar vendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, “Për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2015 në lidhje me kallëzimin penal nga ana e shtetasit G.S.*

Pas vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit Vlorë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar procedimin penal me nr. ***, viti 2017, për veprën penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Veprimet hetimore të këtij procedimi janë kryer sërish nga subjekti i rivlerësimit dhe, në vijim të detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit Vlorë, nga ana e organit të akuzës janë kryer disa veprime hetimore si: administrimi i dosjes së pronës pranë ALUIZINI-it; administrimi i dosjes së ndërtimit të pallatit nga ZVRPP-ja; informacioni nga IMT-Vlorë në lidhje me vendimmarrjen për prishjen e objektit; si dhe janë pyetur shtetasit K.LL, M.L dhe G.S.

Në përfundim të hetimeve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur sërish *pushimin e këtij procedimit penal, pasi fakti nuk parashikohet si vepër penale dhe i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesën me objekt “pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2017, të regjistruar për veprën penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal.*

Në përfundim, Gjykata e Apelit Vlorë, sërish, me vendimin nr.***, datë 26.3.2019, ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. ***³⁷, datë 5.2.2019, me arsyetimin se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk ka bërë një përcaktim të saktë të rrethanave të faktit dhe në përfundim dhe në mungesë të një analize serioze të të gjitha provave të grumbulluara, të ballafaquara me dispozitat ligjore për kryerjen e veprës penale “mashttrim” dhe në fund, me pa të drejtë ka konkluduar se të kallëzuarit nuk e kanë kryer këtë vepër penale në dëm të viktimës G.S.*
- *Në gjendjen që janë aktet e procedimit penal nr. 1944, të vitit 2017, ekzistojnë dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova se qoftë nga ana e personave, të cilët kanë pasur funksione publike pranë Policisë Ndërtimore, të ngarkuar me ekzekutimin e akteve administrative përkatëse, qoftë nga ana e pronarit të truallit, shtetasit K.LL, nuk janë mbajtur në konsideratë parashikimet e nenit 35 të ligjit “Për legalizimet”, në rastin e prishjes së objektit në posedim të kallëzuesit G.S, duke sjellë pasoja në drejtim të të drejtave dhe interesave legjitime të këtij shtetasi.*
- *Veprimet hetimore shitesë të kryhen brenda një periudhe 2-mujore.*

Komisioni iu drejtua Prokurorisë së Rrethit Vlorë, e cila informon dhe përcjell në Komision vendimin nr. 33, datë 2.6.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në përmbajtje të vendimit konstatohet se subjekti, në përfundim të hetimeve, ka kërkuar sërish pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. 1944/2017 dhe i është drejtuar gjykatës me kërkesë për

³⁷Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 5.2.2019, ka vendosur: *kthimin e akteve të procedimit penal nr.***, të vitit 2017, prokurores Elona Alvora me qëllim kryerjen e veprimeve hetimore, të përcaktuara në pjesën arsyetuese të vendimit; veprimet hetimore të kryhen brenda dy muajsh, nga dita që ky vendim të marrë formë të prerë.*

pushimin e procedimit penal nr. 1994/2017. Gjykata, në përfundim të gjykimit, ka vendosur mospranimin e kërkesës së Prokurorit të Rrethit Gjyqësor Vlorë për pushimin e çështjes penale me nr. 1994, të vitit 2017 dhe i ka lënë organit të akuzës, pra subjektit të rivlerësimit detyrë për kryerjen e veprimeve shtesë hetimore si vijon:

- të bëjë administrimit e CD me pamje filmike origjinale nga TV *** dhe emisioni “****” me regjistrimin e bisedës midis kallëzuesit dhe të kallëzuarit K.LL;
- marrjen në pyetje dhe kryerjen e ballafaqimit midis dy të kallëzuarve dhe kallëzuesit G.S;
- pyetjen e ndërtuesit M.L që ka bërë pallatin;
- kryerjen e të gjitha veprimeve hetimore të tjera që mund të jenë të nevojshme.

Ndaj vendimit nr. ***, datë 2.6.2021, të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Vlorë, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit Vlorë në datën 30.7.2021.

Kjo çështje ka 5 vjet që shqyrtohet nga institucionet dhe nuk ka gjetur ende një zgjidhje.

1.1 Konstatime të Komisionit lidhur me çështjen, ku duket se:

- nuk janë kryer veprimet hetimore brenda kohës së vendosur nga gjykatat për kryerjen e hetimeve shtesë;
- nuk janë kryer hetime të plota dhe shteruese, referuar vendimeve të gjykatave, të cilat kanë urdhëruar në mënyrë të përsëritur kryerjen e veprimeve hetimore, pretendim i cili është ngritur edhe nga denoncuesi/kallëzuesi G.S.

Komisioni, mbi këto konstatime, i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën.

1.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti, në prapësime, ka shpjeguar³⁸ se: “*Problematikën e tij shtetasi G.S e ka paraqitur te Prefekti Vlorë, i cili më shkresën nr. *** prot., datë 26.4.2005, e ka orientuar denoncuesin që t’i drejtohet gjykatës për zgjidhje, pasi të gjitha institucionet e kanë trajtuar çështjen administrativisht. Rreth 10 vjet më vonë, shtetasi S i është drejtuar Prokurorisë me një kallëzim me të cilin kërkon ndjekjen penale.*

Në rastin në fjalë është evident fakti se çfarëdo veprimi hetimor të kryhet në vitin 2005 nuk mund të hyjë në fuqi ligji nr. 9482/2006 për të konsideruar veprimin e ekzekutimit të një vendimi për prishjen e objektit të ndërtuar pa leje nga shtetasi G.S si shpërdorim detyre në kuptim të nenit 248 për shkak se ligjet mbi të cilat ushtrohet detyra duhet të jenë në fuqi në kohën kur kryhen veprimet. Në cilësinë e prokurores, në çështjen në fjalë në thelb është duke u operuar vetëm me funksionin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor që nuk ka afat të përcaktuar, pasi ushtrimi i ndjekjes penale nuk mund të bëhet për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale të parashikuar nga neni 66 i Kodit Penal, pra nuk mund të pretendohet se je mashtruar me pasojë lejimin e institucioneve të zbatojnë aktet administrative të nxjerra dhe të pakundërshtueshme gjyqësisht sikurse është ekzekutimi i vendimeve për prishjen e objektit në vitin 2005”.

³⁸Subjekti i bashkëlidh shpjegimeve: ankimin e datës 15.2.2019; vendimin gjyqësor të ankimit nr. ***, datë 5.2.2019; ankimin e datës 30.7.2021; dhe vendimin gjyqësor të ankimit nr. ***, datë 2.6.2021.

1.3 Vlerësimi i Komisionit

Në analizë të fakteve dhe rrethanave, dokumentacionit dhe shpjegimeve e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni vërejt se subjekti i rivlerësimit kishte treguar disa mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore të materialit kallëzues të shtetasit G.S, për sa gjykatat e kanë kthyer çështjen disa herë për rihetim, duke mos vlerësuar të drejtë pushimin e hetimeve.

Sipas akteve të administruara, kjo çështje është ende në shqyrtim. Komisioni, pasi analizoi dosjet dhe konstatoi disa elemente lidhur me veprimtarinë e subjektit në aspektin profesional, në përfundim i jep rëndësi faktit se vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim. Ndalimi i vlerësimit të aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, në përputhje me pikën 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, ka për synim shmangien e paragjykimit të organeve të rivlerësimit ndaj zgjidhjes së një çështjeje në shqyrtim nga subjekti i rivlerësimit dhe, njëkohësisht, dhe shmangien e paragjykimit të çështjes në dhënien e zgjidhjeve të gabuara nga subjekti i rivlerësimit nën “presionin” apo ndikimin e procesit të rivlerësimit³⁹.

Për shkaqet e mësipërme, Komisioni, duke qenë në kushtet e pengesës kushtetuese, nuk mund të vlerësojë veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit për këtë çështje, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, si dhe duke evidentuar se çështja e denoncuesit ka zgjatur 5 vjet, pa gjetur një zgjidhje, trupi gjykues çmon se kjo dosje duhet të kalojë për vlerësim pranë organi kompetent të ILD-së.

2. Denoncim nr. *** prot., datë 22.11.2021, i depozituar nga av. I.Z

Denoncuesi pretendon se nga ana e subjektit të rivlerësimit ka konstatuar:

- neglizhencë në kryerjen e detyrës dhe papërgjegjshmëri në respektimin e normave procedurale, elementëve bazë të kryerjes së detyrës, pasi nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për të cilin zgjat më parë afatin e hetimit në secilën dosje, nuk ka kryer hetim të thelluar për të siguruar prova;
- moskryerjen e analizës së materialeve ekzistuese në dosje për të zbardhur të vërtetën; si dhe
- shmangien nga funksioni si prokurore, në përmbushje të detyrës funksionale.

Mbi pretendimet e denoncuesit, Komisioni ka marrë aktet e procedimit penal me nr. ***, të vitit 2020, ku veprimet hetimore ishin kryer nga subjekti i rivlerësimit.

Komisioni, pas administrimit të fashikujve penalë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë⁴⁰ konstaton se me kallëzimin nr. ***, viti 2019, i regjistruar për veprën penale “falsifikim dokumentesh”, i parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, me kallëzues shtetasin F.H është kërkuar ndjekja penale ndaj shtetasit F.V për veprën penale “falsifikim dokumentesh”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal dhe veprën penale “pastrim i produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

³⁹Qëndrim ky i mbajtur nga Kolegji sipas vendimit: http://kpa.al/wp-content/uploads/2022/01/***.doc

⁴⁰Shkresë nr. *** prot., datë 16.12.2021, kthim përgjigje nga Prokuroria në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Pas regjistrimit të materialit kallëzues me nr. *** nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurores së çështjes, ndër të tjera, janë kryer këto veprime hetimore:

- Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është administruar kopja e dosjes gjyqësore (fashikulli ku ndodhen të administruara provat) mbi bazën e së cilës është marrë vendimi me nr. ***, datë 29.10.2002, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Është pyetur me cilësinë e deklaruesit shtetasi F.H, i cili ka deklaruar se pretendimet e tij në lidhje me vendimin nr. ***, datë 14.6.1995, të KKKPronave ish Pronarëve Bashkia Vlorë lidhet me faktin se ky vendim është marrë përpara se toka bujqësore të përfshihej me vendim të KRRTSH-së brenda Bashkisë Vlorë. Ai shprehet se ky fakt (pra, përfshirja e mëvonshme e tokës bujqësore brenda Bashkisë Vlorë) ka qenë shkak i marrjes së vendimit gjyqësor nr. ***, datë 29.3.2012, nga Gjykata e Apelit Vlorë. Në deklaratimet e tij, shtetasi shprehet se: *“I.A është pronar autokton i pronës së tij te vendi ‘***’ dhe nuk ka dyshim që vendimi në emër të këtij subjekti të mos jetë ligjor. E kundërta është për familjen V, sepse vendimi nr. ***, datë 14.6.1995, të ish KKKP Vlorë, te vërejtje citon ‘prona është pa kufij të saktë, megjithatë jepet vendimi nr. ***, datë 14.6.1995’. Pra, ky fakt është në kundërshtim me ligjin, sepse nuk ka asnjë arsye që të jepet vendim për një pronë pa kufijtë përkatës. Megjithatë, është organi procedues që duhet të verifikojë këtë fakt, të cilin e kemi mbështetur me dokumente përkatëse. Aktualisht, ky vendim po përdoret në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, në procesin e iniciuar sërish nga familja V, kundër përfituesve të tokës bujqësore të familjes SH”*.

Në përfundim të hetimeve, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurores së çështjes me vendimin e datës 17.7.2019 ka vendosur *mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal me nr. ***, pasi fakti i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale*. Pasi ka ardhur në dijeni të këtij vendimi, kallëzuesi F.H ka paraqitur ankim duke e kundërshtuar vendimin e mosfillimit të procedimit penal nr. ***.

Në përfundim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka argumentuar se duhet të kryhen edhe veprimet të tjera hetimore. Në përfundim të shqyrtimit me vendimin nr. ***, datë 26.1.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur:

- Kthimin e akteve të çështjes penale nr. ***, të vitit 2020, regjistruar për veprën penale “falsifikim dokumentesh”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke urdhëruar kryerjen e këtyre veprimeve hetimore.
- Kryerjen e aktekspertimit në lidhje me përmbajtjen dhe nënshkrimet për vendimin nr. ***, datë, 14.6.1995, të protokolluar me nr. *** prot., datë 19.7.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Bashkia Vlorë, dokumentit të administruar pranë ATP-së dhe të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit dhe ato të paraqitur nga pala dhe të nënshkruara vetëm nga Kryetari i Komisionit (f. 26 e fashikullit të mosfillimit).

Kundër vendimit me nr. ***, datë 26.1.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit në datën 5.2.2021⁴¹.

2.1 Konstatime të Komisionit

Nga tërësia e veprimeve procedurale edhe pse çështja është në gjykim e sipër konstatohen veprime dhe mosveprime individuale të subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë ndikuar në zvarritjen e pajustificuar të gjykimit të çështjes. Subjekti, edhe pas urdhërimeve nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë duket se nuk i ka dhënë zgjidhje procedimit për një periudhë të gjatë kohore, ka vonuar nxjerrjen e rezultateve të hetimit në mënyrë të pamotivuar, pasi nuk ka kryer menjëherë verifikime të mundshme kur ishte e nevojshme.

Komisioni i kërkoi subjektit të provojë të kundërtën e konstatimeve sa më sipër.

2.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti, në prapësime, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Në prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është depozituar kallëzimi i shtetasit F.H me nr. ***, prot., datë 2.7.2019. Pas kthimit nga Gjykata e Apelit me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 10.12.2019, në datën 20.5.2019 është regjistruar procedimi penal me nr. ***, viti 2020, për hetimin e veprës penale ‘falsifikim dokumentesh’, e parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.*

Në datën 27.11.2020 është vendosur paraqitja e kërkesës për pushim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga gjykata është vendosur se çështja duhet të rikthehet për shkak se kryerja e veprimit të ekspertimit grafik nëse vlerësohet e nevojshme përbën urdhër dhe jo veprim diskrecional të Gjykatës së Apelit Vlorë. Nga ky moment, fashikulli hetimor i kësaj çështjeje është paraqitur vetëm më 11.3.2022 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndërkohë që vendimi gjyqësor më shënimet përkatëse nga gjykata ishte sjellë më parë. Pasi fashikulli ka ardhur në prokurori është vendosur rifillimi i hetimit paraprak më 17.3.2022, në rastin në fjalë ndryshe nga sa ju konstatoni nuk bie në sy mbajtja e çështjes në proces verifikimi për periudhën 2.7.2019 - 17.7.2019 dhe më pas prishjes së vendimmarrjes së mosfillimit në proces hetimi për periudhën 20.5.2020 - 27.11.2020.

Në rastin në fjalë, ajo që është për t’u diskutuar është qëndrimi i mbajtur nga prokurori i apelit në kushtet kur një gjyqtar e ka konsideruar të drejtë vendimmarrjen e prokurorit të çështjes, ndërsa prokurori i apelit kërkon prishjen edhe të vendimit të prokurorisë për mosfillim, edhe të vendimit gjyqësor përkatës që e ka konsideruar të drejtë vendimmarrjen”.

Subjekti i bashkëlidh shpjegimeve akte penale të hetimeve të kryera për këtë procedim⁴².

⁴¹Në aktet e procedimit penal përcillet edhe akti nr.***, datë 5.3.2021, drejtuar Gjykatës së Apelit Vlorë, me të cilin është përcjellë dosja gjyqësore e vendimit nr. ***, datë 26.1.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

⁴²Urdhër për rifillimin e hetimit paraprak: shkresa nr. *** prot., datë 11.3.2022, për kërkimin e fashikullit të hetimit paraprak; shkresa nr.*** prot., datë 15.2.2022, për paraqitjen e vendimit të formës së prerë; vendimi nr. ***, datë 16.3.2021, i Gjykatës së Apelit; kërkesa për pushim datë 27.11.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, së bashku me shkresën njoftuese; urdhër për regjistrimin e procedimit penal datë 20.5.2020; dërgimi i vendimit të formës së prerë nr.***, datë 8.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të depozituar më 13.5.2020; vendimi nr. ***, datë 10.12.2019, i Gjykatës së Apelit Vlorë, ku rezultoi edhe qëndrimi i prokurorit të apelit për të prishur vendimmarrjen për mosfillimin e procedimit penal dhe vendimmarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë që e kishte konfirmuar këtë vendimmarrje.

2.3 Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna, dokumentacionit të depozituar, por edhe në tërësi të dinamikës së shqyrtimit të kësaj çështjeje, vëren në kontekstin e ushtrimit të rolit dhe punës së subjektit të rivlerësimit në këtë çështje, konstatohet se janë vlerësuar dhe ndërmarrë disa veprime hetimore, pas të cilave subjekti ka arritur në vendimmarrjen përkatëse.

Nisur nga fakti që kjo çështje rezultoi të ishte ende në shqyrtim gjyqësor, në zbatim të pengesës ligjore të parashikuar në pikën 2, neni E, i Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet se *vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim*, si dhe orientimeve të Kolegjit⁴³, trupi gjykues çmon se kjo çështje se nuk mund të vlerësohet nga Komisioni. Pretendimet e ngritura nga denoncuesi në lidhje me veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit për këtë denoncim janë për t'u vlerësuar më tej nga organi kompetent i ILD-së.

3. Komisioni mori dijeni (sipas një informacioni të marrë nga media⁴⁴ e shkruar) se subjekti i rivlerësimit dyshohej se kishte favorizuar të pandehurin E.B në kërkesën për caktimin e masës së sigurimit ndaj tij.

Komisioni, lidhur me vërtetësinë dhe verifikimin e informacionit sa më sipër, iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me kërkesën për kopje të akteve të procedimit penal nr. *** të vitit 2021, të regjistruar në emër të shtetasit E.B.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë⁴⁵ ka përcjellë në Komision kopje të fashikullit hetimor të procedimit penal nr. *** të vitit 2021. Sipas akteve penale ka rezultuar se kjo prokurori ka regjistruar procedimin penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit E.B. Në datën 16.6.2021, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë është regjistruar çështja penale me nr. ***, datë 16.6.2021 me objekt “Vleftësim arresti, caktim mase sigurimi në ngarkim të shtetasit E.B”, akuzuar për veprat penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, “prodhim i armëve dhe i municioneve luftarake, lëndëve plasëse, i bombave apo minave, pa lejen e organeve kompetente shtetërore”, të parashikuara me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet, nga neni 278/1 i Kodit Penal. Në seancën gjyqësore të datës 18.6.2021, është marrë në shqyrtim kjo kërkesë penale dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është kërkuar masa e sigurisë “arrest shtëpie”.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka vendosur sipas kërkesës së paraqitur nga prokuroria.

3.1 Konstatime të Komisionit

Pas analizimit të akteve penale të procedimit nr. ***, Komisioni konstatoi se:

- subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim për përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit E.B, në datën 11.9.2021, pa u kryer edhe veprimi hetimor i ekspertimit të aparateve telefonike, veprim hetimor ky i urdhëruar nga vetë subjekti;

⁴³http://kpa.al/wp-content/uploads/2022/01/****

⁴⁴https://shqiptarja.com/lajm/****

⁴⁵Kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 2.11.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

- baza ligjore, neni 327 i Kodit të Procedurës Penale, në vendimin për zgjatjen e afateve të hetimit marrë nga subjekti i rivlerësimit në datën 11.9.2021, është e gabuar, pasi nga hetimi rezultoi se relacioni i dorëzuar i OPGJ-së mban datën 25.8.2021;
- akti procedural penal, kërkesë për gjykim, i datës 19.10.2021, nuk ka nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit, i cili është një nga elementet e vlefshmërisë së akteve procedurale penale.

Komisioni i kërkoi subjektit të provojë të kundërtën e konstatimeve sa më sipër.

3.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësime, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “ ... personi që unë kisha në ndjekje penale ishte person që para disa kohësh Prokuroria e Vlorës ka regjistruar procedimin penal nr. *** të vitit 2021 dhe kishte për objekt veprën penale të vrasjes së mbetur në tentativë dhe armëmbajtjes pa leje sepse atentati ndaj personit u bë me armë zjarri, pas këtij momenti personi u kap me armë zjarri gjatë një kontrolli që ka bërë policia... gjatë kontrollit të ushtruar janë sekuestruar disa sende, një pjesë e të cilave është disponuar, janë disponuar prej meje ndërkohë që aparati telefonik është urdhëruar këqyrja e tyre...

Unë si prokurore kam thënë thjesht të bëj një këqyrje të aparateve telefonike, ndërkohë që prokurori përkatës ka marrë një vendim për kryerje të ekspertimit dhe duke qenë se ajo ishte një vepër penale më e rëndë, policia ka parë me prioritet dërgimin në Institutin e Policisë Shkencore të aparaturës me qëllim që të kryhej ekspertimi. Si rregull, për veprat penale 278 në asnjë rast ne nuk e urdhërojmë kryerjen e ekspertimit telefonik, nuk është normale në procedurat tona, por për vrasjet dhe për çështje të tjera të rënda sigurisht kryerja e këtij lloj veprimi është, le të themi, në listën e veprimeve që duhet të kryhet në kuadër të hetimit. Në rastin konkret, vendimi për kryerjen e ekspertimit nuk i përket çështjes time dhe nuk është urdhërim në kuadër të çështjes time.

Urdhërimi në kuadrin e çështjes time ka qenë të bëhet këqyrja e pjesa e telefonave. Ajo që ka ndodhur është që këto lloj ekspertimesh, pavarësisht se ligji thotë do duhet të kryhen brenda një afati të caktuar, realisht prokuroria nuk ka instrument që ta detyrojë, le të themi, institutin e policisë shkencore dhe t'i thotë do të ma bësh për kaq kohë... Në rastin konkret, ajo që ka ndodhur është që veprimi ka qenë urdhëruar që të kryhej, nuk po kryhej dhe në datën 11.9.2021 është marrë vendimi për zgjatjen e afatit dhe vendimin për zgjatjen e afatit ia kam dërguar oficerit të policisë gjyqësore në e-mail, ju e dini që prokurorët nuk kanë nënshkrim elektronik, pra dokumenti është elektronik por nuk e ka një nënshkrim të tillë.

Oficeri i policisë gjyqësore ka printuar e-mail-in tim, ka printuar aktin përkatës dhe ia ka komunikuar personit dhe avokatit të tij, sikurse është detyrimi ligjor... Pasi ka ndodhur kjo pjesë në datën 13, oficeri i çështjes ku po hetohej për vrasje më ka informuar që akti i ekspertimit të telefonave ende nuk kishte ardhur, ky ka qenë shkaku që ne kemi vijuar më pas me procedurën për njoftimin e akuzës dhe procedurën për marrjen e personit të pandehur. Dua të sqaroj se respektimi i nenit 327 është thelbësor... nëse prokurori vlerëson që hetimi ka qenë i plotë ai do duhet të marrë një njoftim për përfundimin e hetimit paraprake dhe nëse, le të themi, ka një akuzë që mund t'i qëndrojë gjykimin, ai merr vendimin për marrjen e tij të pandehur. Në rastin konkret, vendimi për marrjen të pandehur dhe njoftimi për përfundimin e

hetimit paraprak ish in akte të ndërmarra përpara se të bëhej zgjatja e afatit dhe, për këtë arsye, në zgjatjen e afatit referuar gjithmonë informacionit të grumbulluar që policia gjyqësore po thoshte që nuk mund të kryhet veprimi i këqyrjes, nuk është veprim i cilësuar i domosdoshëm në vendimin për zgjatjen e afatit ...”.

3.3 Vlerësimi i Komisionit

Në përfundim, pas analizimit të akteve penale të procedimit nr. *** dhe deklarimeve e shpjegimeve të dhëna nga subjekti pas njohjes me rezultatet e hetimit, Komisioni arrin në konkluzionin se ka të bëjë me vlerësim të çështjes që diktohet nga bindja e brendshme e subjektit të rivlerësimit.

Komisioni, në rastin konkret, çmon aftësitë profesionale të prokurorit, pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet, në zbatim kjo të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për këtë arsye, në vlerësimin final të kësaj çështjeje, trupit gjykues nuk i rezultuan *indicie* apo elemente në çështje të tjera për të ngritur dyshime se subjekti ka një mënyrë/model pune të papajtueshëm me pozicionin e saj apo shkelje të respektimit të të drejtave të palëve.

Rivlerësimi i aftësive profesionale sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, bazuar në opinionin e Komisionit të Venecias⁴⁶ dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese⁴⁷, të cilët kanë vendosur qartë kufirin ndarës për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, i cili bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, Komisioni nuk i çmoi problematikat e evidentuara dhe të trajtuara në këtë vendim si shkaqe që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit E të Aneksit të Kushtetutës apo që ta bëjnë të papërshtatshëm në drejtim të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, në zbatim të pikës 1 të nenit 42 dhe të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, është kryer vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, duke u vlerësuar se subjekti i rivlerësimit:

- a) ka treguar aftësi të mira profesionale, sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016;
- b) ka treguar aftësi të mira organizative, sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016;
- c) ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016;

⁴⁶Shihni opinionin nr. ***, të Venecias.

⁴⁷Shihni vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

ç) ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar *i aftë* profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Elona Alvora ka plotësuar së bashku kushtet vijuese:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Elona Alvora, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatën së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
2. Transferimin e procedimeve penale nr. *** dhe nr. *** të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në organin kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

4. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 7.6.2022

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Suela ZHEGU
Relatore

Xhensila PINE
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka